



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 7931 / 3 Prot.

Tiranë, 09.06. 2023

Lënda: **NJOFTIM**  
**Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë**

Drejtuar: **TË GJITHË AUTORITETEVE/ENTEVE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të neneve 23/d, 129 dhe 130 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (në vijim “LPP”), Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në ushtrim të detyrave që LPP i ngarkon, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”) verifikoi zbatimin e ligjshmërisë për disa procedura prokurimi, të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore, gjatë viteve 2021 dhe 2022.

Këto procedura u verifikuan në kuadër të zbatimit të një plani verifikimi, në të cilin u përfshinë procedurat e denoncuara në APP nga operatorë ekonomikë. Procedurat e denoncuara i përkasin prokurimeve me vlerë të vogël.

Në përfundim të procesit të verifikimit, APP ka propozuar marrjen e masës disiplinore për 34 punonjës në autoritetet kontraktore subjekt verifikimi.

Marrë shkas nga gjetjet e evidentuara në kuadër të procesit të verifikimit, me qëllim orientimin e autoriteteve/enteve kontraktore drejt zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore për prokurimin, në zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël, APP sjell në vëmendje si vijon:

1. Në kuadër të hartimit të specifikimeve teknike, autoritetet/entet kontraktore duhet të dokumentojnë procesin e hartimit dhe argumentimit të specifikimeve teknike, për objektin e prokurimit, konform parashikimeve të nenit 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (në vijim “VKM”). Gjithashtu, procesverbali i argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim duhet të publikohet së bashku me ftesën për ofertë, në sistemin e prokurimit elektronik, sikurse cilësohet në Udhëzimin e APP Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.



Njëkohësisht, autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë se, specifikimet teknike duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit. Në këtë kuptim, duhet të përcaktojnë të gjitha detajet e nevojshme, si psh: përmasat përkatëse për zërat e produkteve objekt prokurimi.

Nga ana tjetër, autoritetet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë dokument/e konkret, në përmbushje të kërkesave teknike të përcaktuara, me qëllim që operatorët ekonomikë të provojnë përmbushjen e tyre.

2. Në kuadër të përllogaritjes së fondit limit, autoritetet/entet kontraktore duhet të veprojnë sipas parashikimeve të neneve 34 të LPP dhe 76 të VKM, duke argumentuar dhe dokumentuar mënyrën e përllogaritjes, si dhe të pasqyrojnë treguesit përkatës të çmimeve.

Treguesit e çmimeve të marra në kuadër të testimit të tregut, si një nga mënyrat e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës të parashikuar në nenin 76 të VKM, duhet të evidentohen në procesverbalin e mbajtur për këtë proces, së bashku me të dhënat e operatorëve, nga të cilët janë marrë çmimet përkatëse.

Gjithashtu, në rastin e përllogaritjes së fondit limit bazuar në çmimet e tregut, APP rekomandon që autoritetet/entet kontraktore të mbajnë në konsideratë llogaritjen e mesatares së ofertave, për të qenë sa më afër çmimeve reale të tregut.

3. Autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje parashikimet e neneve 77 të LPP dhe 78 të VKM, në hartimin e kërkesave të kualifikimit, të përcaktuara në ftesën për ofertë, si dhe të argumentojnë domosdoshmërinë e tyre.

Autoritetet/entet kontraktore nuk duhet të kërkojnë:

- Certifikata ISO, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, si dhe pa dhënë arsye konkrete mbi nevojën e përfshirjes së tyre në dokumentet e procedurës së prokurimit.
- Kërkesë për eksperiencë të mëparshme të operatorëve ekonomikë mbi 3 vjet nga shpallja e njoftimit të kontratës për mallra/shërbime dhe mbi 5 vjet për punë publike, duke iu referuar parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Gjithashtu, duke qenë se, në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, fondi limit nuk përcaktohet në ftesën për ofertë, autoritetet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë një vlerë konkrete minimale të lejuar, për të cilën ofertuesit duhet të provojnë realizimin e eksperiencave të mëparshme të ngjashme.
- Punonjës që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë, pa argumentuar teknikisht domosdoshmërinë për punonjësit e kërkuar, sipas profileve përkatëse. Megjithëse, objekti i prokurimit mund të realizohet vetëm me staf punonjësish, është i nevojshëm argumentimi teknik, sikurse kërkojnë edhe rregullat e prokurimit publik, duke u bazuar në shërbimet që do të kryejë secili dhe afatin e kryerjes së shërbimit.
- Certifikatë e sigurimit industrial (CSI)/certifikatë e lëshuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në kushtet kur, një kërkesë e tillë nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e prokurimit. Autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë se, nëse do të vlerësohej prej tyre se kontrata për objektin në fjalë të prokurimit lidhet me masa sigurie për



efekt të informacionit të klasifikuar, duhet t'i referohen legjislacionit në fuqi për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

- Paraqitjen nga operatori ekonomik i renditur në vend të parë, të formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit për procedurat mbi kufirin monetar për prokurimet me vlerë të vogël, nëse nuk janë përcaktuar në ftesën për ofertë kritere të përgjithshme dhe të veçanta, për të cilat operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë përmbushjen e tyre, sipas këtij formulari.

Një kërkesë e tillë do të krijonte konfuzion për operatorët ekonomikë, si dhe hapësirë për subjektivizëm gjatë procesit të vlerësimit.

Gjithashtu, autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje:

- Të përcaktojnë dokumentin/et konkret, që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë, pasi, në të kundërt, krijohet konfuzion jo vetëm për operatorët ekonomikë gjatë procesit të ofertimit, por edhe për procesin e vlerësimit të ofertave.

- Të respektojnë Udhëzimin e APP Nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, në përcaktimin e afatit të lëvrimit.

Afat i lëvrimit të mallit apo realizimit të shërbimit/punës lidhet me përfundimin e procedurës së prokurimit dhe nënshkrimin e kontratës përkatëse, në rastet kur nënshkruhet një e tillë, si dhe ky afat duhet të fillojë pas përfundimit të afatit të ankimit.

4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet të kryhet në përputhje me kriteret e kualifikimit, të përcaktuara në ftesën për ofertë. Referuar nenit 92 të LPP, një ofertë vlerësohet e vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Po në bazë të këtij parashikimi ligjor, autoritetet/entet kontraktore nuk duhet të skualifikojnë operatorë për arsye që nuk qëndrojnë dhe vijnë në kundërshtim me kërkesat e kualifikimit. Në rastet e skualifikimit, autoritetet/entet kontraktore duhet të evidentojnë arsyet e skualifikimit të operatorëve, në procesverbalin e mbajtur për vlerësimin e ofertave.

Autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë parashikimet e Udhëzimit të APP Nr. 3, datë 12.04.2022 "Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë" (në rastet kur kërkohet paraqitje e mostrave). Referuar këtij udhëzimi, autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë procesverbal mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik, nëpërmjet të cilit dokumentohet procesi i administrimit të tyre, si dhe detajet që përshkruajnë mostrat e paraqitura.

Gjithashtu, në rastin e paraqitjes së ofertave ekonomike me vlerë të njëjtë, autoriteti/enti kontraktor duhet të vijojë me hedhjen e shortit, sipas parashikimeve në nenin 82 të VKM dhe në Udhëzimin Nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.



Së fundmi, autoritetet/entet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje të dokumentojnë procesin e verifikimit të dokumentacionit në formë të shkruar, të operatorit ekonomik të renditur në vend të parë, duke cilësuar dokumentet e paraqitura nga operatori, si dhe duke specifikuar edhe formën e paraqitjes së tyre (original ose fotokopje e noterizuar).

Duke ju falenderuar për vëmendjen,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Reida Kashta**

